



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatësi Emilio Gati  
Gjykatësi Kai Ambos

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 16 korrik 2021

**Gjuha :** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi apelin kundër “Vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave”**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit:**

Gregori Kihou

**Mbrojtësit të viktimave:**

Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit:**

Ben Emerson

**Mbrojtëses së parashtruesve të :**  
**kërkesave të refuzuara**

Ani Pues

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit:**

Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:**

Venkatesvari Alagenda

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “paneli i Gjykatës së Apelit” ose “paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”)<sup>1</sup> duke vepruar në pajtim me nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) është ngarkuar me shqyrtimin e një apeli të parashtruar më 7 qershor 2021 nga mbrojtësja e parashtruesve të kërkesave të refuzuara, viktimat 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06 (përkatësisht, “parashtruesit e kërkesave të refuzuara”<sup>2</sup> dhe “apeli”,<sup>3</sup>), kundër “Vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave” (“Vendimi i apeluar”).<sup>4</sup> Parashtruesit e kërkesave të refuzuara kërkojnë nga paneli të anulojë Vendimin e apeluar dhe t’i pranojë parashtruesit si viktimë pjesëmarrëse në procesin gjyqësor (“VPP”) të kësaj çështjeje.<sup>5</sup> Veseli dhe Krasniqi u përgjigjën se apeli duhet të rrëzohet (përkatësisht, “Përgjigja e Veselit” dhe “Përgjigja e Krasniqit”).<sup>6</sup> Të akuzuarit e tjerë dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) nuk dorëzuan përgjigje lidhur me apelin. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara nuk u kundërpërgjigjën. be

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 tetor 2020, ZPS-ja paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar (“Aktakuza”).<sup>7</sup>

<sup>1</sup> F00005, Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit, 7 qershor 2021.

<sup>2</sup> F00293, Njoftim për caktimin e mbrojtësit për parashtruesit e kërkesave të refuzuara, 12 maj 2021, para. 8.

<sup>3</sup> F00004/RED, Version i redaktuar publik i apelit kundër “Vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave” në pajtim me rregullën 113(6) të Rregullores, 7 qershor 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 7 qershor 2021) (“Apeli”).

<sup>4</sup> F00257/RED, Version i redaktuar publik i Vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, 21 prill 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 21 prill 2021) (“Vendimi i apeluar”).

<sup>5</sup> Apeli, para. 51.

<sup>6</sup> F00006, Përgjigja e Mbrojtjes së Veselit ndaj apelit të mbrojtëses kujdestare të viktimave parashtruese të kërkesave - KSC-BC-2020-06/IA005-F00004/RED (“Përgjigja e Veselit”), 15 qershor 2021, para. 7; F00007, Përgjigja e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj apelit kundër “Vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave në pajtim me rregullën 113(6) të Rregullores, 17 qershor 2021 (“Përgjigja e Krasniqit”), para. 32.

<sup>7</sup> F00034/A01, Aktakuza, 30 tetor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*); F00045/A03, Aktakuza e rishikuar më tej, 4 nëntor 2020 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, riklasifikuar si publike më 5 nëntor 2021) (“Aktakuza”).

2. Më 4 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat për pjesëmarrje në proces (“Vendimi Kornizë”).<sup>8</sup>

3. Më 21 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin e apeluar, në të cilin, ndër të tjera, refuzoi si të papranueshme kërkesat e parashtruesve të refuzuar.<sup>9</sup>

## II. STANDARDI I RISHIKIMIT

4. Paneli i Gjykatës së Apelit vendosi një standard rishikimi për apelet e ndërmjetme në vendimin e tij të parë dhe e zbatoi atë më pas edhe në këtë çështje.<sup>10</sup>

5. Paneli i Gjykatës së Apelit rikujton se, sipas rregullës 113(6) të Rregullores, personat të cilëve u refuzohet kërkesa kanë vetvetiu të drejtën e apelit të vendimit që refuzon pranimin e tyre si viktimë pjesëmarrëse dhe përfaqësimin e përbashkët të tyre në proces.<sup>11</sup>

## III. DISKUTIM

6. Në pikën (a) të apelit, parashtruesit e kërkesave të refuzuara pretendojnë se në kundërshtim me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, krimet si pasojë e të cilave ata pësuan dëm përfshihen brenda kuadrit kohor, gjeografik dhe material të

---

<sup>8</sup> F00159, Vendimi kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat, 4 janar 2021 (“Vendimi Kornizë”).

<sup>9</sup> Vendimi i apeluar, para. 85. Paneli thekson se viktimë 06/06, kërkesa e së cilës gjithashtu u refuzua në Vendimin e apeluar, pranon vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake; shih Apeli, para. 1.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-07, F00005, Vendim mbi apelin e Hysni Gucatit për çështje të lidhura me arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgim, 9 dhjetor 2020, para. 4-14. Shih gjithashtu F00005, Vendim mbi apelin e Kadri Veselit kundër vendimit lidhur me lirimin e përkohshëm, 30 prill 2021, para. 4-7; F00005/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi apelin e Jakup Krasniqit kundër vendimit lidhur me lirimin e përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 30 prill 2021), para. 4-7; F00005/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi apelin e Rexhep Selimit kundër vendimit lidhur me lirimin e përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 30 prill 2021), para. 4-7; F00005/RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi apelin e Hashim Thaçit kundër vendimit lidhur me lirimin e përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni origjinal u dorëzua më 30 prill 2021), para. 4-7.

<sup>11</sup> Shih gjithashtu rregullën 113(5) të Rregullores.

krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të pretenduara në Aktakuzë.<sup>12</sup> Në pikën (b) të apelit, parashtruesit e kërkesave të refuzuara pretendojnë se viktimat që kanë pësuar dëm si rezultat i kriterit të përgjithshëm të krimeve kundër njerëzimit, që paraqiten në Aktakuzë, duhet të pranohen si viktimë pjesëmarrëse në proces.<sup>13</sup> Gjithashtu, në pikën (c) të apelit parashtruhet që interpretimi që Gjykatësi i Procedurës Paraprake i bën llojit të lidhjes që duhet të ekzistojë midis dëmit të pësuar nga viktimat dhe Aktakuzës, është i gabuar.<sup>14</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit së pari do të trajtojë së bashku pikat (a)-(c) të apelit, pasi ato lidhen me interpretimin që Gjykatësi i Procedurës Paraprake i bën kriterit sipas të cilit “dëmi i pësuar [nga një viktimë] duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale të përfshirë në Aktakuzë”.<sup>15</sup>

7. Në pikën (d) të apelit parashtruesit e kërkesave të refuzuara pretendojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka marrë parasysh natyrën vazhduese të krimit të zhdukjes me forcë, dhe ndikimin në aftësinë e parashtruesve të kërkesave të refuzuara për të dhënë informacione të caktuara.<sup>16</sup> Në pikën (e) të apelit, parashtruhet se secili prej parashtruesve të kërkesave të refuzuara ka demonstruar se kërkesa e tij duhet të miratohet.<sup>17</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit do t’i trajtojë pikat (d) dhe (e) të apelit së bashku, pasi ato kanë të bëjnë me vlerësimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të kërkesave të paraqitura nga parashtruesit e kërkesave të refuzuara.

#### A. INTERPRETIMI NGA GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE I KRITERIT SIPAS TË CILIT DËMI I PËSUAR DUHET TË JETË REZULTAT I DREJTPËRDREJTË I NJË VEPRE PENALE TË PËRFSHIRË NË AKTAKUZË (PIKAT (A)-(C))

<sup>12</sup> Apeli, para. 20-21, që i referohen paragrafit 48 të Vendimit të apeluar. Shih gjithashtu Apeli, para. 22-31.

<sup>13</sup> Apeli, para. 32-33, që i referohen paragrafit 45 të Vendimit të apeluar.

<sup>14</sup> Apeli, para. 34-42.

<sup>15</sup> Rregulla 113(4) e Rregullores.

<sup>16</sup> Apeli, para. 43-46.

<sup>17</sup> Apeli, para. 47-50. Shih gjithashtu apeli, para. 51.

## 1. Parashtrimet

8. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara argumentojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar duke konstatuar se krimet si pasojë e të cilave ata pësuan dëm “nuk përfshihen brenda kuadrit kohor, gjeografik dhe material të akuzave të ngritura në Aktakuzën e Konfirmuar”, edhe pse ata kanë dhënë prova *prima facie* që tregojnë të kundërtën.<sup>18</sup>

9. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara pranojnë se ngjarjet që qëndrojnë në themel të kërkesave të tyre përkatëse nuk janë renditur në Listat A-C të Aktakuzës.<sup>19</sup> Megjithatë, ata parashtrojnë se përmendja në Aktakuzë e një fushate përndjekjesh në shkallë të gjerë ndaj kundërshtarëve dhe deklarata se “incidentet e zhdukjes me forcë të personave *përfshijnë* ato të përshkruara në Listën C” tregojnë se lista e këtyre incidenteve nuk është shteruese por shërben si shembull.<sup>20</sup>

10. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara pretendojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar duke u mbështetur në “kuadrin e akuzave” dhe nuk ka arritur të bëjë dallimin mes “akuzave” dhe “krimeve” që pretendohet se kanë ndodhur sipas Aktakuzës; ata parashtrojnë se kjo e para përcakton dhe kufizon bazën faktike të përgjegjësisë së të akuzuarve, ndërsa e dyta është kategori më e gjerë dhe përcakton pjesëmarrjen e viktimave.<sup>21</sup> Sipas tyre, krimet që pretendohet se kanë ndodhur sipas Aktakuzës janë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit që, ndër të tjera, janë kryer me anë të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, përndjekjes, zhdukjes me forcë dhe vrasjes së paligjshme.<sup>22</sup> Këto janë pikërisht krimet të cilat u kanë shkaktuar dëm parashtruesve të kërkesave të refuzuara dhe për të cilat ata kanë dhënë prova *prima facie*.<sup>23</sup> Parashtruesit e kërkesave të refuzuara më tej kundërshtojnë

---

<sup>18</sup> Apeli, para. 20-22, që i referohen paragrafit 48 të Vendimit të apeluar. Shih gjithashtu, apeli, para. 23-31.

<sup>19</sup> Apeli, para. 22.

<sup>20</sup> Apeli, para. 23, që i referohet paragrafëve 32, 37, 57, 171 të Aktakuzës (theksimi është shtuar në apel).

<sup>21</sup> Apeli, para. 24-29, 31.

<sup>22</sup> Apeli, para. 25.

<sup>23</sup> Apeli, para. 25.

argumentin e paraqitur nga njëri prej të akuzuarve para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>24</sup>

11. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara gjithashtu pretendojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar duke arritur në përfundimin se përmendjet e elementëve kontekstualë të krimeve kundër njerëzimit:

nuk përfshihen brenda fushëveprimit të rregullave 2 dhe 113(1) të Rregullores, pavarësisht nëse përmendje të tilla kanë të bëjnë me krime të ngjashme me ato që përbëjnë akuzat. Çdo interpretim i ndryshëm do të çonte në pranimin e VPP-ve të cilat nuk do të kishin lidhje me akuzat e saktësuara në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>25</sup>

12. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara pretendojnë se ata kanë vuajtur si rezultat i incidenteve që janë pjesë e kriterit të përgjithshëm të krimeve kundër njerëzimit, d.m.th. “sulmit të përhapur gjerësisht ose sistematik të drejtuar kundër një popullate civile”.<sup>26</sup> Ata më tej pretendojnë se interpretimi që Gjykatësi i Procedurës Paraprake i bën llojit të lidhjes që duhet të ekzistojë midis vuajtjeve të viktimave dhe Aktakuzës nuk arrin të marrë parasysh vuajtjet e tyre kolektive si dhe interesat e tyre personale.<sup>27</sup> Lidhur me vuajtjet kolektive, parashtruesit e kërkesave të refuzuara mbështeten veçanërisht në Parimet dhe Direktivat Themelore të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për Mjete Juridike dhe Zhdëmtim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të të Drejtave Universale të Njeriut dhe të Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare (“Parimet Themelore të OKB-së”),<sup>28</sup> në jurisprudencën e Dhomave të Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias

<sup>24</sup> Apeli, para. 29-30.

<sup>25</sup> Apeli, para. 32, 34, që i referohen paragrafit 45 të Vendimit të apeluar.

<sup>26</sup> Apeli, para. 32-33. Shih gjithashtu nenin 13(1) të Ligjit.

<sup>27</sup> Apeli, para. 34-42.

<sup>28</sup> United Nations, General Assembly, A/RES/60/147, Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law/Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, A/RES/60/147, Parimet dhe Direktivat Themelore për Mjete Juridike dhe Zhdëmtim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të të Drejtave Universale të Njeriut dhe të Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, 16 dhjetor 2005.

(“DHJGJK”) dhe në Juridiksionin Special për Paqe në Kolumbi (“JEP”).<sup>29</sup> Lidhur me interesin personal të viktimave, parashtruesit e kërkesave të refuzuara pretendojnë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk arriti të zbatojë arsyetimin e Dhomës së Apelit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) në çështjen *Lubanga*.<sup>30</sup>

13. Veseli përgjigjet se parashtruesit e kërkesave të refuzuara thjesht nuk pajtohen me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe kërkojnë të krijojnë një kategori të re dhe spekulative viktimash që nuk parashikohet në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara.<sup>31</sup> Ai parashtron se paneli duhet të refuzojë sugjerimin e parashtruesve të kërkesave të refuzuara se viktimat që nuk kanë pësuar dëm të drejtpërdrejtë si rezultat i veprimeve të pretenduara kriminale të një të akuzuari, duhet të lejohen të japin ndihmën e tyre për të nxjerrë të vërtetën lidhur me akuzat për krime dhe të kenë të drejtën për zhdëmtim.<sup>32</sup>

14. Krasniqi përgjigjet se parashtruesit e kërkesave të refuzuara nuk arrijnë të gjejnë ndonjë gabim në interpretimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të “veprës penale të pretenduar në Aktakuzë”, sipas rregullës 113(1) të Rregullores që kërkon që parashtruesi i kërkesës të ketë pësuar dëm si rezultat i një krimi konkret që është brenda parametrave të saktë të akuzave që përmban Aktakuza.<sup>33</sup> Ky kriter mbështetet gjerësisht nga jurisprudenca ndërkombëtare. Ky kriter siguron që viktimat të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive në procese gjyqësore, të kërkojnë të vërtetën dhe në fund të kërkojnë zhdëmtim në një mënyrë që nuk e zgjeron kuadrin e gjykimit përtej akuzave që përmban Aktakuza.<sup>34</sup> Sipas mendimit të tij, interpretimi i sugjeruar

<sup>29</sup> Apeli, para. 35-37. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara i referohen: parathënies dhe paragrafit 8 të Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara që theksojnë se viktimizimi mund të drejtohet kundër grupeve të personave që vihen në shënjestër kolektivisht; jurisprudencës së DHJGJK-së që njeh dimensionin e viktimizimit kolektiv; dhe JEP-së ku subjekte kolektive u pranuan të marrin pjesë në proces.

<sup>30</sup> Apeli, para. 40-41.

<sup>31</sup> Përgjigja e Veselit, para. 2, 5.

<sup>32</sup> Përgjigja e Veselit, para. 3-4, 6.

<sup>33</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 14, 16, 22-23, 32.

<sup>34</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 18-20, 22. Shih gjithashtu, Përgjigja e Krasniqit, para. 27-28, 32. Në përgjigje të pretendimeve të parashtruesve të kërkesave të refuzuara lidhur me vuajtjen kolektive,

i parashtruesve të kërkesave të refuzuara për të përfshirë, ndër të tjera, viktimat e supozuara të elementit të përgjithshëm të krimeve kundër njerëzimit, do të ishte i gabuar dhe në kundërshtim me të drejtat e të akuzuarve.<sup>35</sup>

15. Duke trajtuar argumentet konkrete të parashtruesve të kërkesave të refuzuara, Krasniqi parashtron se përdorimi i fjalëve të papërcaktuara qartë, të tilla si “përfshin” është një mangësi e Aktakuzës që është trajtuar në një mocion të Mbrojtjes, vendimi për të cilin ende pritet të merret.<sup>36</sup> Ai gjithashtu parashtron se vendimi i apeluar është në përputhje me jurisprudencën e GJPN-së (duke përfshirë atë të cituar në apel) dhe se nuk ishte e nevojshme të diskutoheshin çështjet e viktimave në një kuptim kolektiv ose teorikisht, por përkundrazi të përcaktohej nëse duhej pranuar secili parashtrues kërkesë të merrte pjesë në këtë proces gjyqësor.<sup>37</sup>

## 2. Vlerësimi

16. Paneli së pari do të trajtojë çështjen e kuptimit të “veprës penale të pretenduar në Aktakuzë” në kontekstin e rregullës 2 dhe 113(1) të Rregullores, duke përcaktuar përkatësisht nocionin e viktimës dhe nocionin e VPP-së. Paneli refuzon pretendimin e parashtruesve të kërkesave të refuzuara se përmendja e “veprës penale të pretenduar në Aktakuzë” duhet kuptuar si krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera, ndër të tjera, me anë të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, përndjekjes, zhdukjes me forcë dhe vrasjes së paligjshme.<sup>38</sup> Përkundrazi, paneli pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se krimi ose krimet në lidhje

---

Krasniqi nënvizon se përmendja e DHJGJK-së në kontekstin aktual nuk ndihmon sepse kriteret për pjesëmarrjen e viktimave në DHJGJK janë të ndryshme nga ato në Dhomat e Specializuara, veçanërisht sepse në rastin e DHJGJK-së, viktimat nuk ka të drejtë të kompensohet për dëmin individual dhe material; shih Përgjigja e Krasniqit, para. 23(a). Shih gjithashtu, Përgjigja e Krasniqit, para. 26.

<sup>35</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 17, 21, 24.

<sup>36</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 23(c).

<sup>37</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 25-28. Krasniqi më tej argumenton se burimet e cituara nga parashtruesit e kërkesave të refuzuara kanë lidhje me kontekste të tjera dhe nuk mund të ndihmojnë në përcaktimin e grupit të viktimave pjesëmarrëse në një proces gjyqësor konkret para Dhomave të Specializuara; shih Përgjigja e Krasniqit, para. 25-26.

<sup>38</sup> Apeli, para. 25.



me të cilin ose të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon të jetë viktimë duhet të përfshihet ose përfshihen në parametrat materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave, siç saktësohet në Aktakuzë.<sup>39</sup>

17. Ky interpretim mbështetet nga jurisprudenca e gjykatave të tjera, pavarësisht nga kontekstet e ndryshme procedurale. Në rastin e GJPN-së, Dhoma e Apelit arriti në përfundimin që në proces gjyqësor duhet të marrin pjesë vetëm viktimat që kanë lidhje me akuzat.<sup>40</sup> Në rastin e Tribunalit Special për Libanin (“TSL”), Gjykatësi i Procedurës Paraprake sqaroi se “lidhja shkak-pasojë që kërkohet midis dëmit të pësuar dhe ‘sulmit që përfshihet në juridiksionin e Tribunalit’ duhet të interpretohet si kërkesë për ekzistencën e një lidhjeje midis dëmit të pretenduar dhe veprës penale për të cilën është ngritur një akuzë konkrete në Aktakuzë”.<sup>41</sup> Në rastin e DHJGJK-së, Dhoma e Procedurës Paraprake konstatoi se viktimat që dëshirojnë të marrin pjesë në proces duhet të provojnë se dëmi i pësuar nuk është thjesht i lidhur me ndonjë prej krimeve që përfshihen në juridiksionin e DHJGJK-së dhe vendosi që “parashtruesi i kërkesës duhet të provojë se ai ose ajo ka pësuar lëndim si një pasojë e drejtpërdrejtë e të paktën një prej krimeve që pretendohet se ka kryer ( i akuzuari ose kanë kryer të akuzuarit” .<sup>42</sup>

---

<sup>39</sup> Vendimi i apeluar, para. 45.

<sup>40</sup> ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1432, Judgment on the appeals of The Prosecutor and The Defence against Trial Chamber I’s Decision on Victims’ Participation of 18 January 2008, 11 July 2008 (“*Lubanga Appeal Decision*”), paras 2, 58, 62. Shih gjithashtu ICC, *Prosecutor v. Yekatom and Ngāissona*, ICC-01/14-01/18-738, Decision on Victims’ Participation in Trial Proceedings, 23 November 2020, paras 20-21; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-211, Decision on Victims’ Participation at the Confirmation of Charges Hearing and in the Related Proceedings, 15 January 2014, para. 27; ICC, *Prosecutor v. Muthaura et al.*, ICC-01/09-02/11-267, Decision on Victims’ Participation at the Confirmation of Charges Hearing and in the Related Proceedings, 26 August 2011, para. 60.

<sup>41</sup> STL/TSL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT/PTJ, Fourth Decision on Victims’ Participation in the Proceedings (“*Ayyash et al. Fourth Decision on Victims’ Participation*”), 2 May 2013, para. 15.

<sup>42</sup> ECCC/DHJGJK, *Co-Prosecutors v. Ieng et al.*, 002/19-09-2007-ECCC/OCIJ, Public Redacted Decision on Appeals Against Co-Investigating Judges’ Combined Order D250/3/3 Dated 13 January 2010 and Order D250/3/2 Dated 13 January 2010 on Admissibility of Civil Party Applications, 27 April 2010, para. 28. Paneli më tej thekson se rregulla e brendshme 23bis(1)(b) e DHJGJK-së u miratua më 9 shkurt 2010 duke përfshirë këtë formulim: “në mënyrë që padia civile të jetë e pranueshme, paditësi duhet të [...] b) demonstrojë se, si pasojë e drejtpërdrejtë e të paktën një prej krimeve që pretendohet se ka kryer personi i akuzuar, ai ose ajo faktikisht ka pësuar lëndim fizik, material ose psikologjik [...] (theksimi është

18. Sipas nenit 22(3) të Ligjit, “interesi personal dhe të drejtat e viktimës në procedurën penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi.” I njëjti nen parashikon “zhdëmtimin e arsyeshëm të viktimave nga i akuzuari i cili e ka pranuar fajësinë apo është gjykuar të jetë fajtor për ndonjë krim (krime) që ka rezultuar të jetë drejtpërdrejt i dëmshëm për viktimat”. Paneli pajtohet me interpretimin e Veselit dhe Krasniqit lidhur me këtë pikë, përkatësisht se “pranimi” dhe “zhdëmtimi” kanë lidhje vetëm me dëmin e drejtpërdrejtë të shkaktuar nga veprimet e kryera nga një i akuzuar në lidhje me një krim për të cilin është ngritur akuzë në një Aktakuzë.<sup>43</sup> Gjithashtu, paneli konstaton se dhënia e statusit të VPP-së viktimave të krimeve për të cilat nuk janë ngritur akuza konkrete ndaj një të akuzuari dhe, të cilat në fund konstatohet se janë provuar nga gjykatësit, do të sillte rrezikun që një i akuzuar të ngarkohej në mënyrë të padrejtë me detyrimin për të zhdëmtuar viktimën ose viktimat për krimin ose krimet për të cilin ose të cilat, i akuzuari nuk është shpallur fajtor.<sup>44</sup>

19. Së fundi, paneli bazuar në parashtrimet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesave të refuzuara, në kundërshtim me argumentin e paraqitur nga një prej të akuzuarve para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, thekson se pranimi i tyre si VPP nuk do të zgjerojë kuadrin e akuzave e as do të ndikojë në të drejtat e të akuzuarve për një gjykim të drejtë.<sup>45</sup> Megjithatë, parashtruesit e kërkesave të refuzuara nuk arrijnë të përcaktojnë konstatimet që ata synojnë të kundërshtojnë apo të identifikojnë

---

shtuar); shih ECCC, Internal Rules, Rule 23bis(1)(b)/ DHJGJK, Rregullorja e Brendshme, rregulla 23bis(1)(b).

<sup>43</sup> Shih Përgjigjja e Veselit, para. 6; Përgjigjja e Krasniqit, para. 17(d).

<sup>44</sup> Shih, rregulla 158(1) e Rregullores që parashikon se pas mbylljes së çështjes, trupi gjykues tërhiqet për të kuvenduar për shpalljen e vendimit “në lidhje me akuzat në aktakuzë” (theksimi është shtuar). Shih gjithashtu, rregulla 167(2) e Rregullores ku përcaktohet që “në funksion të kërkesave për dëshmipërblim të paraqitura në gjykatat vendore, aktgjykimi i përcjellë sipas paragrafit (1) është i formës së prerë dhe detyruar në lidhje me përgjegjësinë penale të personit të dënuar për dëmin e shkaktuar”.

<sup>45</sup> Apeli, para. 29-30, që i referohen paragrafit 40 të Vendimit të apeluar, i cili përmbledh parashtrimet e paraqitura nga Krasniqi sipas të cilit pranimi i parashtruesve të kërkesave të refuzuara si viktimë pjesëmarrëse në proces do të zgjeronte parametrat e çështjes përtej akuzave aktuale; shih F00209, Përgjigjja e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj raportit të parë të ZPV-së, 1mars 2021, para. 21.

ndonjë gabim të bërë nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në atë drejtim. Rrjedhimisht, paneli i refuzon këto parashtrime.<sup>46</sup>

20. Paneli tani do të trajtojë pretendimin e parashtruesve të kërkesave të refuzuara se ata vuajtën si pasojë e incidenteve që janë pjesë përbërëse e kriterit të përgjithshëm ose atij kontekstual të krimeve kundër njerëzimit dhe se këto incidente duhej të ishin shqyrtuar në mënyrën e duhur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>47</sup> Konstatimi i panelit se në gjykim marrin pjesë vetëm viktimat që kanë lidhje me krimet për të cilat janë ngritur akuza, lidhet domosdoshmërisht me veprimet që pretendohet se ka kryer i akuzuari. Qëllimi për të provuar ekzistencën e një “sulmi të përhapur gjerësisht ose sistematik të drejtuar kundër një popullate civile”, siç kërkohet në nenin 13(1) të Ligjit, është që të përshkruhet konteksti në të cilin duhet të ndodhin veprimet e të akuzuarve.<sup>48</sup> Qëllimi nuk është krijimi i një kategorie krimesh që është e veçantë apo e pavarur nga krimet themelore. Një krim kundër njerëzimit përbëhet nga krimi themelor (p.sh. vrasja e paligjshme) dhe elementi kontekstual. Për këtë arsye, ekzistenca e vetëm elementit kontekstual nuk mund të mjaftojë për të arsyetuar statusin e VPP-së. Edhe nëse parashtruesit e kërkesave të refuzuara kanë vuajtur si pasojë e incidenteve që përfshihen në elementin e përgjithshëm të krimeve kundër njerëzimit, nëse incidentet në fjalë nuk kanë lidhje me veprimet konkrete të të akuzuarve në kuadër të krimeve themelore për të cilat ata akuzohen, ato janë të parëndësishme për të vendosur për pjesëmarrjen e viktimave.

21. Pasi arriti në përfundimin se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka gabuar në konstatimin se krimi ose krimet në lidhje me të cilin ose të cilat parashtruesi i

<sup>46</sup> Shih, për shembull, KSC-BC-2020-07, F00007, Vendim mbi apelet e Mbrojtjes kundër vendimit për mocionet paraprake (“Vendim mbi apelet në lidhje me mocionet paraprake në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*”), 23 qershor 2021, para. 15.

<sup>47</sup> Apeli, para. 32-33.

<sup>48</sup> Shih p.sh. ICC/GJPN, Elementët e krimeve, neni 7 (Krimet kundër njerëzimit), para. 2 (“Dy elementet e fundit për çdo krim kundër njerëzimit përshkruajnë kontekstin në të cilin duhet të ndodhin veprimet. Këto elemente përcaktojnë se nevojitet pjesëmarrja dhe dijenia për një sulm të përhapur gjerësisht ose sistematik të drejtuar kundër popullatës civile”). Shih gjithashtu neni 13(1) i Ligjit.

kërkesës pretendon të jetë viktimë, duhet të përfshihen në parametrat e akuzave të ngritura në Aktakuzë,<sup>49</sup> paneli tani do të trajtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesave të refuzuara se lista e krimeve të përshkruara në Aktakuzë nuk është shteruese.<sup>50</sup> Paneli vëren pretendimin e Krasniqit se përdorimi i fjalëve të papërcaktuara qartë të tilla si “përfshin” është një mangësi e Aktakuzës që është trajtuar në një mocion paraprak të Mbrojtjes, vendimi për të cilin ende pritet të merret.<sup>51</sup>

22. Paneli është i mendimit se kjo temë është përcaktuese për rezultatin e këtij vendimi dhe, për këtë arsye, duhet të trajtohet në këtë fazë. Megjithatë, paneli do të kufizojë vlerësimin e vet në rastin konkret të identifikuar nga parashtruesit e kërkesave të refuzuara. Në lidhje me këtë, paragrafi 171 i Aktakuzës përcakton që “ndër incidentet e zhdukjes me forcë të personave *përfshihen* ato të identifikuar në Listën C dhe të përshkruara në paragrafët 137, 139, 142, 147, 149, 150, 152, 157 dhe 163 më lart.”<sup>52</sup>

23. Në pajtim me nenet 21(4)(a) dhe 38(4) të Ligjit, si dhe me rregullën 86(3) të Rregullores, aktakuza duhet të përcaktojë me përpikmëri dhe qartësi të mjaftueshme faktet që mbështesin akuzat për krime, duke përfshirë edhe format e përgjegjësisë penale. Kjo buron drejtpërdrejt nga parimi që i akuzuari ka të drejtën të njoftohet për llojin dhe shkakun e akuzës kundër tij/saj, siç parashikohet në nenin 30(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 6(3)(a) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Akuzat kundër një të akuzuari dhe faktet materiale që mbështesin ato akuzat duhet të paraqiten me saktësi të mjaftueshme në aktakuzë, në

---

<sup>49</sup> Vendimi i apeluar, para. 45.

<sup>50</sup> Apeli, para. 23.

<sup>51</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 23(c), që i referohet F00221, Mocion paraprak i Mbrojtjes së Krasniqit që pretendon mangësi në Aktakuzë, 15 mars 2021, para. 14, 58-60.

<sup>52</sup> Theksimi është shtuar.

mënyrë që i akuzuari të jetë i njoftuar dhe t'i jepet mundësia të përgatisë mbrojtjen në mënyrën e duhur.<sup>53</sup>

24. Paneli konstaton se, derisa Prokuroria të bëjë të ditura detajet shtesë në mënyrë të mjaftueshme, i akuzuari ka të drejtë të vijojë me arsyetimin se ajo çka është paraqitur në listë është shteruese.<sup>54</sup> Paneli gjykon se përmendja në Aktakuzë e fjalës “incidentet [...] përfshirë ato të identifikuar në Listën C”<sup>55</sup> mund të cenojë të akuzuarit, pasi mund të shihet si një orvatje për t'i rezervuar ZPS-së të drejtën për të zgjeruar bazën faktike të akuzave duke shtuar fakte të reja materiale, pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konfirmuar akuzat.<sup>56</sup> Gjithashtu, paneli thekson se në Vendimin e Konfirmimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi akuzën e zhdukjes me forcë të personave vetëm për incidentet e renditura në Listën C dhe të përshkruara më tej në Aktakuzë.<sup>57</sup> Për këto arsye, Lista C, e lexuar së bashku me pjesët përkatëse të Aktakuzës,<sup>58</sup> ofron një përshkrim shterues të krimeve të zhdukjes me forcë për të cilat akuzohen të akuzuarit.

<sup>53</sup> Shih p.sh. Vendim mbi apelet në lidhje me mocionet paraprake në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 35-36 dhe referencat e cituara aty.

<sup>54</sup> Shih p.sh. ICTY, *Prosecutor v. Stanišić and Simatović*, IT-03-69-PT, Decision on Defence Preliminary Motions, 14 November 2003, f. 5; ICTY, *Prosecutor v. Hadžihasanović et al.*, IT-01-47-PT, Decision on Form of Indictment, 7 December 2001, para. 43. Shih gjithashtu ICTR, *Muvunyi v. Prosecutor*, ICTR-2000-55A-A, Judgement, 29 August 2008, para. 99-100.

<sup>55</sup> Aktakuza, para. 171 (theksimi është shtuar).

<sup>56</sup> Shih p.sh. ICC/GJPN, *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-465-Red, Public Redacted version of Decision on the confirmation of charges, 16 December 2011, para. 81. Shih gjithashtu ICC, *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-373, Decision on the Confirmation of Charges Pursuant to Article 61(7)(a) and (b) of the Rome Statute, 23 January 2012, para. 99.

<sup>57</sup> F00026/RED, Version i redaktuar publik i Vendimit për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 30 nëntor 2020 (versioni origjinal u dorëzua më 26 tetor 2020), para. 418-436.

<sup>58</sup> Shih Aktakuza, f. 51, ku ZPS-ja përcakton se “të gjitha pjesët e kësaj Aktakuze, duke përfshirë edhe Listat e saj, duhen lexuar bashkërisht me njëra-tjetrën”. Paneli nënvizon se Listat A-C të Aktakuzës japin mjaft hollësi për vendet dhe datat e përafërta të kryerjes së krimeve të pretenduara në Aktakuzë.

25. Duke iu kthyer argumenteve të parashtruesve të kërkesave të refuzuara mbi vuajtjet e tyre të përbashkëta dhe interesat personale,<sup>59</sup> siç theksoi Gjykatësi i Procedurës Paraprake, parashtruesi i kërkesës pranohet të marrë pjesë si viktimë në proces nëse ka prova *prima facie* që: (a) parashtruesi i kërkesës është person fizik; (b) parashtruesi i kërkesës përshkruan në kërkesë veprime që duket se përbëjnë vepër penale brenda kuadrit të aktakuzës; (c) parashtruesi i kërkesës ka pësuar dëm personalisht; dhe (d) dëmi ka ardhur si pasojë e drejtpërdrejtë e një vepre penale të përshkruar në aktakuzë.<sup>60</sup> Ligji dhe Rregullorja e Dhomave të Specializuara nuk kërkojnë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të shqyrtojë elementë të tjerë, të tillë si vuajtjet e përbashkëta të viktimave apo interesat e tyre personale, për të vendosur mbi pranueshmërinë e kërkesave të viktimave.

26. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara i referohen në vijim JEP-së, mekanizmit gjyqësor të sistemit mjaft të ndërlikuar të drejtësisë kalimtare në Kolumbi (*Sistema Integral de Verdad, Justicia, Reparación y No Repetición*). Paneli thekson se JEP-i përfaqëson një komponent unik gjyqësor të një sistemi kalimtar të drejtësisë, që është produkt i marrëveshjes së paqes të arritur ndërmjet qeverisë së Kolumbisë dhe (ish) grupimit rebel *Fuerzas Armadas Revolucionarios de Colombia-Ejército Popular* ("FARK-UP") që udhëhiqet nga një kuadër ligjor kushtetues i veçantë.<sup>61</sup> Ky model nuk mundet thjesht të transferohet në Dhomat e Specializuara, veprimtaria e të cilave udhëhiqet nga ligje dhe rregulla të ndryshme. Njohja e gjerë e të drejtave për pjesëmarrje të

<sup>59</sup> Apeli, para. 34-42. Parashtruesi e kërkesave të refuzuara parashtrojnë gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë një interpretim të pjesshëm të jurisprudencës së GJPN-së të cilës iu referua në Vendimin e apeluar, kur flet për "lidhjen" midis viktimave dhe krimeve; shih Apeli, para.40.

<sup>60</sup> Vendimi i apeluar, para. 42, që i referohet Vendimit kornizë, para. 28. Shih gjithashtu, neni 22(1) i Ligjit dhe rregullat 2, 113(1) dhe (4) të Rregullores.

<sup>61</sup> Shih përgjithësisht natyrën unike të JEP-së si një mekanizëm i drejtësisë kalimtare, veçanërisht kundrejt gjykatave penale ndërkombëtare, K. Ambos/S. Aboueldahab, *The Colombian Peace Process and the Special Jurisdiction for Peace, Dritto Penale Contemporaneo, Rivista Trimestrale*, 4/2018, f. 256-258. Për një vlerësim gjithëpërfshirës të kohëve të fundit, shih J.L. Fabra-Zamora/ A. Molina-Ochoa and N. Doubleday, eds., *The Colombian Peace Agreement. A Multidisciplinary Assessment*, London and N.Y. (Routledge) 2021 (me referenca të ndryshme për rëndësinë e të drejtave dhe pjesëmarrjes së viktimave, tashmë gjatë bisedimeve të paqes, dhe siç pasqyrohet në kornizën ligjore; lidhur me JEP-në shikoni veçanërisht kontributet e Gobertus E., Ambos dhe Rojas Betancourt).

viktimave, duke përfshirë edhe subjektet kolektive, nga ana e JEP-it,<sup>62</sup> është pasojë e këtij kuadri ligjor unik kushtetues dhe të veçantë për këtë proces kalimtar të drejtësisë. Paneli në këtë kontekst thekson se mundësia e sigurimit të standardeve minimale për një pjesëmarrje reale dhe domethënëse të viktimave në proces ka lidhje me zbatimin e mekanizmave solidë të pjesëmarrjes, në përputhje me kornizën ligjore të gjykatës përkatëse. Në rast të kundërt, pjesëmarrja e gjerë e viktimave mund të shndërrohet lehtësisht në një akt të thjeshtë simbolik, pa ndikim real në zbatimin efektiv të të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe drejtësi.

27. Paneli më tej thekson se njohja e vuajtjes kolektive të viktimave nuk do të thotë domosdoshmërisht të drejta për pjesëmarrje.<sup>63</sup> Ekzistenca ose mungesa e këtyre të drejtave duhet të vlerësohet brenda kuadrit të parametrave të rreptë të mandatit të Dhomave të Specializuara. Konstatimet mbi statusin e viktimave synojnë të përcaktojnë në mënyrë rigoroze grupin e viktimave pjesëmarrëse në kuadër të një procesi gjyqësor konkret, në rastin tonë, procesit gjyqësor që përfshin katër të akuzuarit e kësaj çështjeje. Së fundmi, paneli thekson se kriteret ligjore që zbatohen për VPP-të nuk janë krijuar për të parandaluar pjesëmarrjen e personave që pa asnjë

<sup>62</sup> Colombia, Law 1922 of 2018 Adopting Rules of Procedure for the Special Jurisdiction for Peace (Ley 1922 de 2018, Por medio de la cual se adoptan unas reglas de procedimiento de la Jurisdicción Especial para la Paz), 18 July 2018, Article 2 (“participación colectiva de las víctimas frente a los procesos adelantados ante la jurisdicción especial para la Paz”); Colombia, Jurisdicción Especial para la Paz, Sala de Reconocimiento de Verdad, de Responsabilidad y de Determinación de los Hechos y Conductas, *AUTO No. 02 de 2020*, Acreditación de víctimas colectivas, 17 January 2020, pp. 11-15, 25-26. Shih gjithashtu Apeli, para. 37; Përgjigjja e Krasniqit, para. 26.

<sup>63</sup> Në lidhje me vuajtjet kolektive, paneli vëren se autoriteti i vetëm gjyqësor ndërkombëtar të cilin parashtruesit e kërkesave të refuzuara citojnë në mbështetje të argumenteve të tyre është nga DHJGJK-ja. Paneli pajtohet me argumentet e Krasniqit se DHJGJK-ja ka rregulla të ndryshme procedurale për çështjet që kanë lidhje me zhdëmtimin e viktimave, në të cilat viktimat mundin *vetëm* të kërkojnë dhe të përfitojnë dëmshpërblime kolektive dhe morale. Shih ECCC Internal Rules, Rules 23bis(1)(b), 23quinquies(1); DHJGJK, *Co-Prosecutors v. Ieng et al.*, 002/19-09-2007-ECCC/OCIJ, Decision on Appeals Against Orders of the Co-Investigating Judges on the Admissibility of Civil Party Applications, 24 June 2011, para. 70. Shih gjithashtu, Përgjigjja e Krasniqit, para. 23(a), 26. Gjithashtu, paneli rikujton se standardi i “interesave personale” që preken ka të bëjë me përcaktimin e *modaliteteve* të pjesëmarrjes së viktimave në proces dhe jo me pranimin e viktimave për të marrë pjesë; shih rregulla 114(4) e Rregullores. Për më tepër, Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara kryesisht e përcaktojnë përmbajtjen e të drejtave të viktimave me anë të mjeteve juridike dhe zhdëmtimit. Ato nuk përqendrohen në përkufizimin çka quhet viktimë në kuptimin e ngushtë të një gjykimi konkret. Shih UN Basic Principles, para. 8-9.

dyshim mund të jenë viktimat të krimeve dhe vuajtjeve të rënda. Përkundrazi, kriteret për pjesëmarrjen e viktimave shërbejnë për të siguruar integritetin e procesit penal dhe për të garantuar respektimin e të drejtave të të akuzuarve, si edhe ritmin e shpejtë të procedimit.<sup>64</sup>

28. Së fundmi, paneli pajtohet me parashtruesit e kërkesave të refuzuara se arsyetimi në vijim i Dhomës së Apelit të GJPN-së në çështjen *Lubanga* është në përputhje me kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara: “nëse parashtruesi i kërkesës nuk është në gjendje të tregojë lidhjen midis dëmit të pësuar dhe krimeve konkrete për të cilat janë ngritur akuzat, atëherë edhe nëse interesat e tij ose të saj preken nga një çështje në gjykim, nuk do të ishte e përshtatshme [...] të paraqiten pikëpamjet dhe shqetësimet e tij apo të saj”.<sup>65</sup> Megjithatë, paneli nuk sheh se si ndonjë nga konstatimet e Gjykatës të Procedurës Paraprake mund të kuptohet si në kundërshtim me këtë jurisprudencë.

29. Rrjedhimisht, paneli rrëzon pikat (a)-(c) të apelit të parashtruesve të kërkesave të refuzuara.

## B. VLERËSIMI I GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE TË KËRKESAVE TË REFUZUARA (PIKAT (D)-(E))

### 1. Parashtrime

30. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara argumentojnë se Vendimi i kontestuar nuk trajtoi në mënyrën e duhur krimin e zhdukjes me forcë. Ata përmendin “peshën specifike dhe të skajshme” të këtij krimi.<sup>66</sup> Parashtruesit se “duke pasur parasysh natyrën e zhdukjeve me forcë dhe duke zbatuar të drejtat e viktimave, elementi i lidhjes së gjerë [ndërmjet krimit dhe akuzave të Aktakuzës] duhet të mjaftojë”.<sup>67</sup> Më

<sup>64</sup> Në mënyrë të ngjashme, *Ayyash et al.* Fourth Decision on Victims’ Participation, para. 28.

<sup>65</sup> *Lubanga* Appeal Decision, para. 64; Apeli, para. 40-41.

<sup>66</sup> Apeli, para. 43.

<sup>67</sup> Apeli, para. 47, që i referohet viktimës 08/06. Shih gjithashtu, Apeli, para. 49, që i referohet viktimës 13/06.



tej argumentohet se kur vendndodhja e personit të zhdukur është e panjohur dhe kur viktimat nuk e dinë vendin e saktë të ndalimit ku u mbajt personi, pasi atyre nuk u ishte dhënë asnjë informacion për këtë, standardi i ofrimit të provave *prima facie* vështirë se mund të përmbushet.<sup>68</sup> Gjithashtu, për sa i përket lidhjes kohore me krimet e pretenduara në Aktakuzë, parashtruesit e kërkesave të refuzuara argumentojnë se vepra penale e zhdukjes me forcë është një krim që vazhdon të kryhet për sa kohë që kryesit vijojnë të fshehin fatin dhe vendndodhjen e personave që janë zhdukur.<sup>69</sup>

31. Parashtruesit e kërkesave të refuzuara më tej japin shpjegime lidhur me kërkesat individuale që ata kanë dorëzuar dhe pretendojnë se ata kanë provuar, *prima facie*, ekzistencën e një lidhjeje të mjaftueshme midis dëmit që pësuan dhe krimeve të përshkruara në Aktakuzë.<sup>70</sup>

32. Krasniqi përgjigjet se “pesha e skajshme” e kimit të zhdukjes me forcë nuk kishte rëndësi për Vendimin e apeluar; natyra vazhduese e këtij krimi ishte gjithashtu pa ndonjë rëndësi, përveç nëse provat tregojnë se, në një fazë të caktuar, krimi që po vazhdonte të kryhej u përfshi brenda kuadrit të krimeve të pretenduara në Aktakuzë; dhe se për të përmbushur standardin *prima facie*, viktima duhet të dijë kur dhe ku ishin ndaluar individët përkatës.<sup>71</sup> Gjithashtu, ai pretendon se kërkesat e dorëzuara nga parashtruesit dalin jashtë kuadrit të akuzave në këtë çështje gjyqësore dhe me të drejtë u refuzuan.<sup>72</sup>

## 2. Vlerësimi

33. Paneli interpreton argumentet e parashtruesve të kërkesave të refuzuara mbi “mbrojtjen e domosdoshme të të drejtave të njeriut në rastet e zhdukjeve me forcë”

<sup>68</sup> Apeli, para. 44. Shih gjithashtu, Apeli, para. 47, që i referohet viktimës 08/06. Shih gjithashtu, Apeli, para. 49, që i referohet viktimës 13/06.

<sup>69</sup> Apeli, para. 45. Shih gjithashtu, Apeli, para. 46.

<sup>70</sup> Apeli, para. 47-50.

<sup>71</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 29.

<sup>72</sup> Përgjigja e Krasniqit, para. 30-31.

dhe mbi peshën “specifike dhe të skajshme” të krimit të zhdukjes me forcë,<sup>73</sup> si argumente që i referohen krimit të zhdukjes me forcë të personit si pjesë e krimeve kundër njerëzimit, sipas nenit 13(1)(i) të Ligjit. Për këtë arsye, nuk kërkohet që paneli të merret me çështjen e ekzistencës së zhdukjes me forcë si krim individual (si pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare) brenda kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara.

34. Megjithëse duket se parashtruesit e kërkesave të refuzuara argumentojnë se në Vendimin e apeluar nuk trajtohet “pesha specifike dhe e skajshme të krimit të zhdukjes me forcë”,<sup>74</sup> paneli arrin në përfundimin se ata nuk identifikojnë konstatimet që ata synojnë të kundërshtojnë në lidhje me këtë dhe, gjithashtu, se ata nuk evidentojnë ndonjë gabim që buron nga Vendimi i apeluar. Rrjedhimisht, paneli i rrëzon menjëherë këto parashtrime.<sup>75</sup>

35. Paneli më tej thekson se duket se parashtruesit e kërkesave të refuzuara sugjerojnë që mungesa e saktësisë në disa nga kërkesat e refuzuara në lidhje me vendin ku është kryer krimi i zhdukjes me forcë, është shkaktuar nga vështirësitë që kanë hasur parashtruesit e kërkesave për të mbledhur informacion konkret por që pavarësisht nga kjo, informacioni që është dhënë “duhet të mjaftojë për të provuar lidhjen e domosdoshme” midis krimit ose krimeve të pretenduara nga parashtruesit e kërkesave të refuzuara dhe krimit ose krimeve për të cilin ose të cilat janë ngritur akuzat në Aktakuzë.<sup>76</sup> Paneli rikujton së pari se krimi ose krimet, viktimë e të cilit ose të cilave pretendon të jetë një parashtrues kërkesë, duhet të përfshihet ose të përfshihen brenda parametrave materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave të përshkruara në Aktakuzë.<sup>77</sup> Provat e ofruara në këtë drejtim nga një parashtrues

---

<sup>73</sup> Apeli, para. 43. Shih gjithashtu, Apeli, poshtëshënimi 51.

<sup>74</sup> Apeli, para. 43.

<sup>75</sup> Shih p.sh. Vendim mbi apelet në lidhje me mocionet paraprake në çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, para. 15.

<sup>76</sup> Shih Apeli, para. 47, 49.

<sup>77</sup> Shih më lart para. 16.

kërkese duhet të jenë të mjaftueshme për të përmbushur standardin *prima facie*. Paneli vëren argumentin e parashtruesve të kërkesave të refuzuara se standardi *prima facie* është më i vështirë të përmbushet për viktimat e zhdukjeve me forcë. Megjithatë, duke kujtuar se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bën vlerësim material të besueshmërisë ose saktësisë së informacionit të paraqitur – siç është nënvizuar me të drejtë në Vendimin e apeluar,<sup>78</sup> paneli nuk është i bindur se përmbushja e standardit *prima facie* do të përbente vështirësi të paarsyeshme për parashtruesit e kërkesave, edhe nëse llogariten vështirësitë e tjera shtesë që mund të paraqesë natyra e krimit të zhdukjes me forcë.

36. Lidhur me argumentet mbi natyrën vazhduese të krimit të zhdukjes me forcë dhe pasigurinë lidhur me datën kur ka përfunduar kryerja e këtij krimi, një parashtrues kërkese duhet të paktën të jetë në gjendje të provojë se data e fillimit të kryerjes së krimit të pretenduar ndodhet brenda parametrin kohor të akuzave. Natyra e vazhdueshme e krimit nuk ndikon në faktin se për të qenë VPP, një parashtrues kërkese duhet të përshkruajë në kërkesën e vet ato akte që duket se përbëjnë një vepër penale që përfshihet në Aktakuzë dhe dëmi që parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pësuar duhet të jetë shkaktuar si pasojë e drejtpërdrejtë e një krimi të përshkruar në Aktakuzë.<sup>79</sup> Rrjedhimisht, paneli rrëzon pikën (d) të apelit të parashtruesve të kërkesave të refuzuara.

37. Pavarësisht nga parimet e përgjithshme të rëndësishme që përcaktojnë statusin e VPP-ve para Dhomave të Specializuara të përmendura gjatë këtij Vendimi, paneli vëren se në pikën (e) të apelit, parashtruesit e kërkesave të refuzuara pretendojnë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar në vlerësimin individual të kërkesave të tyre. Ata më tej japin shpjegime në lidhje me kërkesat individuale që ata kanë dorëzuar dhe pretendojnë se kanë provuar, *prima facie*, një lidhje të mjaftueshme midis

<sup>78</sup> Vendimi i apeluar, para. 43, poshtëshënimet 44-45 dhe jurisprudenca e cituar po aty.

<sup>79</sup> Neni 22(1) i Ligjit; rregullat 2(1), 113(1) dhe (4) të Rregullores.

dëmit që pësuan dhe krimeve që përmban Aktakuza.<sup>80</sup> Në këtë fazë, paneli konstaton se nuk është në gjendje të trajtojë plotësisht këtë pikë të apelit.

38. Kjo ndodh sepse Vendimi i apeluar nuk ofron vlerësim individual të kërkesave të refuzuara të viktimave. Në këtë drejtim, paneli rikujton që paragrafi 48 i Vendimit të apeluar që refuzon kërkesat e parashtruesve, është shumë i shkurtër dhe trajton vetëm në mënyrë të përgjithshme argumentin kryesor të parashtruesve të kërkesave të refuzuara. Në pjesën përkatëse, vendimi në fjalë thotë:

Sa u takon [parashtruesve të kërkesave të refuzuara], Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se krimet viktimave të cilave pretendojnë se janë, nuk përfshihen brenda kuadrit kohor, gjeografik dhe material të akuzave të ngritura në Aktakuzën e Konfirmuar, dhe për rrjedhojë bien jashtë fushëveprimit të rregullave 2 dhe 113(1) të Rregullores [...].

39. Paneli është i mendimit se parashtruesit e kërkesave të refuzuara meritojnë, ashtu si të gjithë parashtruesit e kërkesave, një vlerësim individual të kërkesave të tyre. Vendimi i apeluar nuk ofron ndonjë shpjegim ose arsyetim të hollësishëm nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që parashtruesit e kërkesave të refuzuara të kuptojnë plotësisht arsyen pse kërkesat e tyre u refuzuan, me qëllim që ata të kenë mjetet për të kuptuar dhe pranuar vendimin ose, nëse ata nuk e pranojnë atë, të kenë mjetet për ta kundërshtuar. Formulimi i paragrafit 48 të Vendimit të apeluar sugjeron që ky vlerësim është kryer nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Megjithatë, kjo nuk pasqyrohet në Vendimin e apeluar dhe, për këtë arsye, nuk është në dispozicion të parashtruesve të kërkesave të refuzuara ose të panelit. Në këto rrethana, paneli nuk mund të japë një vlerësim për pikën (e) të apelit të parashtruesve të kërkesave të refuzuara.

40. Për këto arsye, paneli shtyn vendimin e tij për pikën (e) të apelit të parashtruesve të kërkesave të refuzuara për një fazë të mëvonshme dhe udhëzon

---

<sup>80</sup> Apeli, para. 47-50.

Gjykatësin e Procedurës Paraprake t'i paraqesë sa më shpejt që të jetë e mundur panelit të Gjykatës së Apelit një vlerësim individual të kërkesave të dorëzuara nga parashtruesit e kërkesave të refuzuara si dhe arsyet që mbështesin konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se parashtruesit e kërkesave të refuzuara nuk pranojnë si viktimë pjesëmarrëse në proces.

#### IV. VENDIM

41. Për arsyet e lartpërmendura, paneli i Gjykatës së Apelit:

**RRËZON** pikat (a) deri (d) të apelit;

**SHTYN** vendimin në lidhje me pikën (e) të apelit; dhe

**IA KTHEN** çështjen Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm në përputhje me paragrafin 40 të këtij Vendimi.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Mishelë Pikar,**  
**Kryegjykatëse**

E premtë, 16 korrik 2021

Në Hagë, Holandë